



Mesxhid Aksa

Pika kritike palestinezo-izraelite

DR. MUSLI VËRBANI

Përgatiti dhe përshtati:
Dr. Musli Vërbani

MESXHIDI AKSAJA
PIKA KRITIKE
PALESTINEZO - IZRAELITE

Kaçanik, 2009

وَقَالَتِ الْيَهُودُ يَدُ اللَّهِ مَغْلُولَةٌ غُلَّتْ أَيْدِيهِمْ وَلُعِنُوا بِمَا قَالُوا بَلْ يَدَاهُ مَبْسُوطَتَانِ يُنفِقُ كَيْفَ يَشَاءُ وَلَيَزِيدَنَّ كَثِيرًا مِنْهُمْ مَا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ مِنَ رَبِّكَ تُطغِيَانَا وَكُفْرًا وَاللَّيْنَانَا بَيْنَهُمُ الْعَدَاوَةُ وَالْبَغْضَاءُ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ كُلَّمَا أَوْقَدُوا نَارًا لِلْحَرْبِ أَطْفَأَهَا اللَّهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ

*“Jehuditë thanë: “Dora e All-llahut është e shtrënguar!”
Qofshin të shtangura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, pse thanë atë. Jo, duart e Tij janë të shkira. Ai furnizon ashtu si të dojë. Kjo që t'u zbrit ty do t'u shtojë disave nga ata (nga paria fetare) shumë largimin dhe mohimin. Ne ndërmjet tyre hodhëm armiqësi dhe urrejtje që do t'u vazhdojë deri në ditën e kijametit. Sa herë që ndezën zjarr për luftë, All-llahu e shoi atë, e ata përpiqen për shkatërrime në tokë. All-llahu nuk i do ngatërrestarët.”*

(El-Maide, 64)

Hyrje

Rruga kolonialiste e kolonizimit jehud është mjeti i vetëm, i cili vërteton ekzistimin e tyre në tokën e palestinezëve musliman.

Jehudët besojnë se kolonizimi është metoda e vetme reale për ekzistimin e vazhdueshëm të tyre, prandaj angazhimi i tyre për kolonizim është i vazhdueshëm.

Jehudët ia kanë arritur qëllimit që t'i themelojnë bazat e rëndësishme në vendet e kolonizuara, që kolonët të kenë ushtri, industri dhe bujqësi në të njëjtën kohë. Me përkrahjen e britanikëve, prej fillimit të themelimit e deri në vitin 1948, ia kanë arritur qëllimit në themelimin e përafërsisht 300 kolonive.

Në fillim plani ka qenë që të themelohen koloni bujqësore, të cilat do të shërbenin në formimin e pikave ku do të përqendroheshin forcat jehude, pika të cilat do t'i shfrytëzonin si baza për të filluar okupimin e vendeve të tjera përreth. Në fillim janë orientuar që të vendosen në disa vende ku ka pasur jehudë, e që pastaj të vazhdojnë në organizimin e themelimit të kolonive përreth tyre, që të dominojnë mbi arabët që janë përreth, që aty të jetë tokë multinacionale si dëshmi për ekzistimin e jehudëve në ato vende. E që pastaj të vazhdohet ndërtimi i kolonive të tjera që ata të jenë qendër e vendeve arabe.

Qëllimi kryesor ka qenë dominimi me kolonë në vendet ku ka banorë të shumtë arabë, por edhe izolimi dhe shkëputja e qyteteve arabe, e pastaj zbrazja e tyre duke zgjeruar kolonitë në kufi me vendet arabe.

Këto koloni kanë përpirë shumë prona, duke ndërtuar kufij për të mos hyrë në qytetet e kolonizuara. Po ashtu, janë vendosur pikat prej ku shpërndahen forcat jehude për të kryer aksionet e tyre armiqësore kundër arabëve.

Ndërsa pas vitit 1967, jehudët nuk flisnin më për ato koloni, por për zgjerimin e atyre kolonive në pjesët e tokave palestineze që ende nuk i kishin përfshirë dhe këto toka të papërfshira të përdoreshin si “Letër xhokeri” për t’i detyruar arabët që me ta të negociohej vetëm për këto toka.

Kështu qeveritë e njëpasnjëshme jehude japin maksimumin e tyre që ta bëjnë të pamundurën të mundur, që qeveria e ardhme të mos tërhiqet nga këto vende. Nuk është vetëm kjo, por ata kanë caktuar vende gjeografike me të cilat e kushtëzojnë çdo qeveri që të mos lëshojë pe në negociatat e mëvonshme. Që ata ta kenë parim thënien e Golda Meir-it se “*Kufiri jehud është deri aty ku banon edhe një jehudi*”.

Kolonizimi është pika e përbashkët dhe kryesorja, e cila i bashkon të gjitha partitë jehude. Dhe çdo mospajtim mes tyre është në politikën e tyre dhe qëllimet e tyre.

Bashkimi i tyre është në premtimin hyjnor të tokës, sa që jehudët çlirimin e tokës dhe kolonizimin e kanë bërë prej farzeve kryesore të fesë së tyre, e cila është e ndërlidhur me besimin e tyre për të cilën nuk ka kompromise.

Haham Musa bin Nahmani ka thënë: “Kolonizimi është e drejtë të cilën e ka dhënë Zoti, e cila nuk mund të hiqet, e po ashtu është pjesë e pandarë e popullit tonë”. “Është pjesë e pashkëputur e sistemit tonë kombëtar.”

Is’hak Shamiri ka thënë: “Përderisa ka toka të pakolonizuara dhe përderisa nuk ka koloni të reja në Bregun Perëndimor, ne nuk përparojmë, por vetëm zmbrazemi.”

Golda Meir ka thënë: “Nuk i kemi përkufizuar kufijtë e Izraelit dhe nuk mund të na përkufizojë askush, por ne jemi ata që i përkufizojmë. Çdo vend që e kolonizoni dhe e mbron ai është vend i kufijve tanë.”

Shimon Perezi ka thënë: “Zgjidhja e vërtetë nuk është zgjidhja me tanke dhe ideologji (sistemit), por zgjidhja me tanke dhe koloni.”

Kur është zhvilluar një debat në mes të Theodor Herzl-it (lider shpirtëror i lëvizjes sioniste dhe Baron Rotçildit (lider shpirtëror i kolonive), i pari i thotë të dytit: *“Kolonia është shtet i vogël, ndërsa shteti është koloni e madhe. Ti dëshiron të themelosh një shtet të vogël, ndërsa unë propozoj themelimin e një kolonie të madhe.”* Atëherë Baroni me një shembull francez të njohur i thotë: *“Duhet që sytë të mos jenë më të mēdhenj se barku.”*

STRATEGJIA E KOLONIZIMIT JEHUD NË BREGUN PERËNDIMOR

Numri i vendkolonive jehud në Bregun Perëndimor ka arritur në 200.

Kolonia e parë ka filluar vetëm pesë javë pas luftës së qershorit të vitit 1967. Plani i kolonizimit, sipas fazave, është si vijon:

E para: *Projekti Alon i vitit 1970.*


Ky projekt është planifikuar gjatë viteve 1967-1976. Në këtë projekt ka qenë e paraparë që 40 % e sipërfaqes së Bregut Perëndimor të kolonizohet, duke përfshirë:

- Mesxhidi Aksanë dhe çka ka rreth saj;
- Shkretëtirën e Jugut të Halilit, të cilën jehudët e quajnë *Shkretëtira Jehude*;
- Rripi i Sigurisë, i cili e përfshin 20 km malin e Jordanisë.


Këtë projekt e ka përgatitur dhe zhvilluar Dejanit në zemër të Bregut Perëndimor, i cili ka qenë i popullzuar në pjesën i cili ndodhet në mes të Nablisit dhe Ramallasë. Ky projekt quhet *Projekti i Njohur i Dejanit* gjatë viteve 1976-1978.

Vendet që i kontrollon Izraeli 

Kolonitë •



E dyta: *Projekti i Grupit Gush Iminijum i vitit 1978*




Këtij plani i është përmbajtur, përafërsisht, Qeveria Likude, e cila ka ardhur në pushtet në qeverinë izraelite në vitin 1978. Ky projekt përmban themelimin e dy zinxhirëve shtesë kolonish në drejtim të veriut, e po ashtu rreth Halilit në pjesën jugore.

Veprimi i Lëvizjes Gush Iminijum është orientuar në uzurpimin e disa shtëpive në qytetet palestineze, për të filluar një formë dhe model të një kolonizimi të ri. Këto koloni më vonë janë quajtur “*Koloni Politike*”.

Kjo lëvizje ka si qëllim bashkimin e ithtarëve jehudë. Është themeluar gjatë luftës së vitit 1973 dhe vepron sipas direktivave shpirtkeqe të politikës masoniste. Te kjo lëvizje dominon mosnjohja e asnjë kriteri, duke terrorizuar dhe futur frikë mes banorëve arab. Program i kësaj lëvizjeje është se kolonizimin e konsideron prej parimeve të besimit jehud dhe veprimet politik. Për shembull, kjo lëvizje i zgjedh apo i cakton pikat dhe vendet gjoja se janë të përmendura në Tevrat, i gjen dhe i kolonizon ato vende me banorë të shumtë, bën përgatitje në llojin e kolonizimit të ri, duke pretenduar se është e drejtë jehude dhe ato duhet të kolonizojnë çdo pëllëmbë toke të Izraelit (Palestinës). Aksioni i tyre përqendrohet në Bregun Perëndimor dhe kodrën jordaneze.

Në deklaratat e saj bën thirrje: “*Do t’i tregojmë qartë çdo izraeliti dhe botës se populli i Izraelit do të luftojë kundër çdo tetantive që na detyron të largohemi nga këto vende, ku çdo pjesë është e Izraelit (edhe pse është palestineze), pa marrë parasysh, ne do ta mbrojmë ushtarakisht apo politikisht.*”

E treta: *Projekti i Organizatës Masoniste botërore e vitit 1983.*



Organizata Masoniste botërore prej vitit 1979-1983 është përqendruar në adresën “Plani gjithëpërfshirës kolonialist në

Jehuda dhe në Samiretun". Qëllimi i këtij projekti ka qenë vendosja e dy milion jehudëve në vendet e kolonizuara, të cilat janë kolonizuar pas vitit 1967 dhe ai projekt të realizohet deri në vitin 2000.

- Plani hapësinor i këtij projekti nuk ka qenë shpërndarja e kolonive vetëm në brendi të qyteteve palestineze, por edhe përreth tyre.

- Ky plan synon që 95 % e sipërfaqes së tokave të Bregut Perëndimor të jenë të lira për t'u kolonizuar me jehudë.

- Plani është projektuar që kolonët të mos jenë të izoluar, por që të jenë të tubuar në përmasa të mëdha ashtu që të kenë mundësi të komunikojnë dhe të shërbehen mes vete në të ardhmen.


Plani është projektuar në mënyrë të tillë që qytetet palestineze të shndërrohen në qytete të vogla, të izoluara prej detit dhe prej qyteteve të reja kolone.

Organizata Masoniste është organizatë e cila është themeluar në Kongresin Masonit, për herë të parë para njëqind vjetësh, më 29-31 gusht të vitit 1897, nën udhëheqjen e Theodor Herzl-it, në qytetin **Bazel** të Zvicrës. Në këtë kongres janë përcaktuar qëllimet që vijojnë:

1. Zhvillimi i ndjenjës kombëtare te jehudët dhe bashkimi rreth qëllimeve sioniste;
2. Përkrahja, nxitja dhe financimi për kolonizimin dhe shkuarja e jehudëve në Palestinë;
3. Lidhja e marrëdhënies me shtete dhe organizata me ndikim botëror, për të gjetur përkrahje për realizimin e qëllimeve jehude;
4. Në fund të kongresit, të cilën e përmendëm më lart, Herzl deklaroi (në kongresin i cili u mbajt në Bazel): *"Është e mundur që të arrihet shteti brenda 50 viteve. Mirëpo, me siguri pas 50 viteve çdo njeri do ta arrijë shtetin jehud."*¹

¹ Lain Meelean, op.cit. f. 524-525.

E katërta: *Projekti i rrugëve për themelimin e vendeve kolonialiste.*



Siç shihet në hartë, Izraeli, sipas këtij projekti, ka planifikuar rrugë të ndërlidhura në mes vete që t'i ngulfatë apo t'i përmbyllë dhe t'i izolojë qytetet e mëdha palestineze. Rruga e fundit, rruga e ashtuquajtur "Rruga 50" është projekt që përfshin: rrugët kryesore (të cilat janë realizuar), rrugët propozuese (të cilat janë në realizim e sipër) dhe rrugët lokale (rrugët mes vendkolonëve).

- Qëllimi i rrugëve është ndërlidhja e rrugëve të Bregut Perëndimor me rrugët e Sistemit (Qeverisë) izraelit.

- Projekti ka për qëllim ndërprerjen e lidhjeve palestineze në mes vete, pra ndërprerjen e lidhjeve që çojnë në fshatrat palestineze.

- Ky projekt bën që rrugët të bëhen qendra kolone, që të ndërlidhen qendrat e qyteteve në mes vete dhe bën që qarkullimi i banorëve dhe ushtrisë të bëhet me lehtësi.

- Këto rrugë mund të kontrollohen me lehtësi prej qyteteve koloniale.

Për t'u siguruar rruga, vendosen pengesat në të dy anën e rrugës. Kështu që rruga përfshin një sipërfaqe me gjerësi prej 240 m, si në rrugët kryesore, ashtu edhe në rrugë lokale dhe me gjatësi prej 600 km dhe e gjithë kjo në dëm të tokave palestineze.

- Rrugët janë projektuar me prapavija shkatërrimi në këtë mënyrë.

Për t'u realizuar projekti i këtyre rrugëve nevojiten të shkatërrohen plantacionet e palestinezëve, duke i prerë me mijëra pemë, si rrushi, fiku dhe ulliri. Këto rrugë ndikojnë që pronat e vogla të humbin në tërësi, ose të mbesin vetëm prona të vogla që nuk mund të shfrytëzohen. Këto rrugë mbyllin çdo mundësi perspektive për zgjerimin e qyteteve apo fshatrave palestineze sipas rritjes normale të banorëve.

PJESA E KUDSIT TË SHENJTË

Jehudët janë përqendruar, që nga fillimi, në Kudsit lindor ashtu që numri i banorëve jehud ka arritur në 170 000, që do të thotë se e tejkalon numrin e banorëve arabë të tanishëm. Brenda 20 viteve të kaluara, nëpërmjet mosdhënies së lejeve për ndërtim arabëve, pra, duke realizuar programin diskriminues, jehudët kanë arritur që Kudsit ta dëmtojnë në pikat në vijim:

- Jehudët e kanë rrethuar Kudsit në dy anë me kolonë: në brendësi, në pjesët e jehudëve ku janë ndërtuar vendbanimet rreth Kudsit lindor; dhe jashtë Kudsit, ku bën pjesë seria e kolonëve që e rrethon Kudsit në jug, në veri, në lindje dhe vazhdon deri në 11 milje prej qendrës së Mesxhidi Aksasë, ku banojnë gjysma e kolonëve jehudë të Bregut Perëndimor, përpos banorëve kolonë të Kudsit fisnik.

- Këto koloni janë pengesë fizike e unitetit të Kudsit me tokat e tjera të Bregut Perëndimor. Po ashtu, ato ndërpresin lidhjet me qytetet kryesore palestineze.

- Ekziston pajtimi politik në mes të të gjitha partive politike për realizimin e programit të qeverisë së Partisë së Punës, program i cili ka për qëllim shtimin e numrit të jehudëve rreth Kudsit, në 120 000 për tri vjet (1995-1998).


- Është zbuluar projekti i fshehtë i Kudsit në vitin 2000, projekt i cili kishte për qëllim shtimin e numrit të jehudëve në një milion. Që do të thotë se numri i tyre të shumëfishohet në krahasim me vitet e kaluara.

- Në mars të vitit 1997 është aprovuar projekti i Qeverisë së Partisë Likude, në fillimin e ndërtimit të kolonisë Har Huma në kodrën Ebu Ganimë, e cila shtrihet në jug të Kudsit, për të plotësuar zgjerimin e kolonëve në drejtim të jugut, prej Mesxhidi Aksasë e që ndërpret lidhjen me qytetin Bejti Lahm.

- Kryetari i Komunës së Kudsit, më 24.08.1997 aprovoi vendimin për ndërtimin e kompleksit të ndërtesave në brendi të Kudsit të arabëve shekullorë, në lagjen Reisil Umud, të cilën e financoi milioneri amerikan jehud, Irfing Moskovç, i cili po ashtu ka financuar në hapjen e kanalit, tash të njohur, kanali brenda mureve të Mesxhidi Aksasë, në vitin 1996.

Komuna e Kudsit, në qershor të vitit 1997, në parim ka aprovuar vendimin e 16 projekteve për ndërtimin e kolonive të reja në brendi të Kudsit arab, projekte të cilat priten të realizohen.





RRIPI I GAZËS

Rripi i Gazës ka 16 koloni kryesore izraelite, ndërsa pas marrëveshjes për paqe i janë shtuar edhe 20 koloni. Prej kolonive më të rëndësishmet janë:

- *Kefar Darum*. Është vendosur mbi shkëmbinjtë e kolonive jehude, të cilat i kanë shkatërruar luftëtarët në vitin 1948, në afërsi të Dejrit Belah.

- *Nitsarim*. Është në mes të Rripit të Gazës. Nga kjo koloni kanë dalë forcat izraelite për të vrarë palestinezët gjatë kryengritjes, e cila ka filluar pas hapjes së tunelit të Kudsit, në muajin Xhumadel Ula, të vitit 1417 (shtator 1996).

- *Kutletu Kutejf*. Përbëhet prej një numri të madh të kolonëve izraelitë (më të rëndësishmet janë: Nitsar Hazanij, Bejt Sejdeh, Kefar Jam, Atsmuma, Nefj Dijkalim).


- *Veriu i Rripit të Gazës* përshin kolonitë: Nisnit Ijlj Sinjarij, Ijriz, Du Gijt.

- Murag. Kjo koloni është vendosur në mes të Refah dhe Han Junusit.

- *Refij Jam*. Është vendosur në bregdetin Refah.

Duhet cekur se numri i banorëve jehudë, të cilët banojnë në këto koloni, nuk e kalon numrin e 5000 banorëve, kur duhet të kihet parasysh se këto koloni përfshijnë 40 % të sipërfaqes së Gazës, kurse në pjesën tjetër banojnë 1.000 000 palestinezë.

Jehuditë mbizotërojnë në të gjitha rrugët, të cilat shpien deri te kolonitë, gjë që e ndan Rripin e Gazës në pjesë të izoluarra, dhe mund t'i mbyllin për çfarëdo shkakut që dëshirojnë dhe kur të dëshirojnë.



KOLONIZIMI NË EPOKËN E PAQES 1992-1997

Pas kthimit të Partisë së Punës në Qeveri, në vitin 1992, kolonizimi u kthye në mënyrën e vjetër dhe me metodat e mëhershme. Këto metoda i kundërshtoi edhe ShBA, mirëpo ai kundërshtim ishte vetëm sipërfaqësor.

E para: Pajtimi për moskonsiderimin e qyteteve arabe brenda qyteteve të banuara me banorë arabë (plani i Gush Imunijumit); dhe

E dyta: Ndërprerja e punëve në disa koloni, te të cilat ende nuk kishte filluar punimi për realizimin e atyre kolonive.

Vetëm se Partia e Punës vazhdoi zgjerimin e punëve në koloni, duke deklaruar se kjo është një rritje natyrore e këtyre kolonive. Kështu që në kohën e qeverisjes së Yitzhak Rabinit është zgjeruar ndërtimi më shumë se sa në kohën e qeverisjes së partisë Likud. Sa që Rabini është krenuar me numrin e banorëve kolonë në vitin 1992 dhe ky vit ia ka tejkaluar të gjitha viteve të mëparshme, prej vitit 1967.

Izraeli ia arriti qëllimit që, gjatë dialogut të fundit në Oslo, tema e kolonëve të mos ishte temë e punëve diplomatike, duke kërkuar që kjo temë të ishte prej temave të mëvonshme dhe përfundimtare, dhe aty u vendos që kjo çështje të debatohej në vitin 1996, mirëpo kjo temë nuk u vendos në rend dite, deri në shtator të vitit 1997, me qëllim që t'i jepej kohë qeverisë së Netanjahut që t'i realizonte programet e saj.

Gjatë kohës së ashtuquajtur *Koha Tranzitore* dhe pas marrëveshjes së Oslos (1993-1996), Partia e Punës ka realizuar projekte të mëdha të kolonive, ose duke i fshehur, ose duke mos i paraqitur fare. Ministri i anashkalonin çështjet dhe heshtnin, ndërsa makineria gërmuese punonte pandërprerë për të rrafshuar dhe ndërtuar sa më shumë koloni. Qeveria jehude, gjegjësisht Shukumu Xhazijt, ish kryetar i shërbimeve sekrete të Izraelit, deklaroi se planifikimi i banorëve, i cili ka qenë paraparë, jo vetëm që do të realizohet, por edhe do të shumëfishohet me kolonë gjatë kohës tranzitore, në krahasim me numrin e mëparshëm.

Në fillim të vitit 1995, qeveria izraelite, sa i përket kolonizimit, paraqiti programin e saj të treshes, i cili kishte për qëllim ndërtimin e 15000 banesave për kolonë, në periferi të Kudsit dhe 13000 banesa në vendet e tjera përreth, si dhe 3000 banesa në vendet e tjera. Ky plan u realizua në periudhën 1995-1998. Sa i përket këtij projekti, Rinçatin, i cili ishte në delegacionin për dialog, duke komentuar Marrëveshjen e Oslos, ka deklaruar: “Le t’i harrojnë ëndrrat palestinezët se Marrëveshja e Oslos i obligon izraelitët që të tërhiqen nga tokat e rëndësishme të Bregut Perëndimor, apo për atë se një ditë prej ditësh Kudsi Lindor do të bëhet kryeqyteti i tyre.” Kështu plani për dhënien e krahinës palestineze dështoi dhe u hoq nga rendi i ditës realizimi i ëndrrës së palestinezëve, edhe pse ishte nënshkruar marrëveshja e paqes.

Numri i banesave, gjatë vitit 1995, ka arritur në 4100, çka shihet qartë se është numër më i madh se çdo vit më parë. Përpos kësaj Izraeli, prej Marrëveshjes së Oslos, ia arriti qëllimit që t’i ruante të gjitha kolonitë, dhe konkretisht:

- Marrëveshja parashihte që gjatë kohës pesëvjeçare tranzitore të mos shpërbëhej asnjë koloni, pra deri në vitin 1999.
- Kolonët, vendet kolone, të kenë status të veçantë dhe t’i kenë resurset natyrore, si për shembull: rrugët kryesore, gypat e

ujit, lidhjet telefonike, të rrymës, burimet e ujit. Palestinezët të mos kenë të drejtë të prekin në asnjë prej këtyre çështjeve.

- Kështu mes dy partive kryesore (Partia e Punës dhe Partia Likude), në vitin 1997, është bërë një marrëveshje që njihet si marrëveshja *Ijtan Bilijn*, për arritjen e zgjidhjes përfundimtare me palestinezët. Mirëpo çdo marrëveshje që ka bërë qeveria izraelite i është përmbajtur parimit që kolonitë izraelite të mos anulohen dhe që e drejta e kolonëve të mos preket. Po ashtu të mos cenohet edhe e drejta e tyre për t'i poseduar pronat e uzurpuara.

Duke parë këto angazhime dhe suksese të izraelitëve, programi i kolonizimit i Qeverisë Likude, nën udhëheqjen e Benjamin Netanjuhut dhe ekzekutuesit, ministrit të urbanizmit dhe ndërtimit banesor, Ariel Sharonit, përmbante nenet në vijim:

- Kolonizimi në Bregun Perëndimor është interes kombëtar, për shkak të sigurimit të instrumentit të sigurisë për shtetin izraelit dhe ka kuptimin e arritjes dhe realizimit të ëndrrave masoniste.

- Qeveria izraelite duhet të ketë në mbikëqyrje ujërat, burimet e ujërave në Golan, në Bregun Perëndimor dhe në Gaza.

- Qeveria izraelite nuk pranon çfarëdo tentimi, i cili cenon përparësinë e kolonëve jehudë dhe çdo kolon jehud duhet t'i shfrytëzojë të gjitha përparësitë. Asnjë qeveri, asnjë shoqatë, asnjë lëvizje, asnjë parti dhe asnjë organizatë nuk mund t'i dirigjojë apo t'i imponojë kurrfarë kushti.

- Pas gjashtëmujorit të qeverisë së Benjamin Netanjahut, partia në opozitë e likudëve, në krye me Is'hak Shamirin, e akuzoi qeverinë se prej ditës së parë të qeverisjes në Bregun Perëndimor nuk ka ndërtuar asnjë koloni, kritikë kjo që ndikoi që qeveria të merrte masa të menjëhershme. Dhe pa kaluar një vit, qeveria mori vendimin që të jepet një donacion prej *një miliard shikil* (300 milion dollarë) për zgjerimin e hapësirave kolone dhe shtimin e kolonëve në atë koloni.

- Qeveria mori vendimin për ndërtimin e kolonisë (Har Huma) në jug të Kudsit. Këtë vendim palestinezët e refuzuan dhe dialogu u ndërpre. Shumica e shteteve nuk e pranuan këtë veprim të Izraelit, mirëpo Izraeli këmbënguli që ky projekt të realizohet edhe pse ndërpritej “Procesi i Paqes”. Sepse Harhuma ka domethënie të veçantë (në gjuhën aberie do të thotë *Kodra mbrojtëse* ose *Kodra Tukë* kodër e cila është rreth Mesxhidi Aksasë.

- Ilija Susa, ministër i punëve të brendshme të Izraelit, ka deklaruar (Lëvizja fetare): *“Izraeli duhet t’i thotë qeverisë palestineze: “Ose Kolonia Har Huma, ose luftë. Dhe duhet ta dinë palestinezët se Har Huma, me dëshirën apo pa dëshirën e tyre, do të ndërtohet.”*

- Kur Ministria e Punëve të Jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkoi nga Izraeli që t’i ndërpriste përkohësisht punët në Har Huma, që të vazhdonte negociatat me palestinezët, zëdhënësi i Qeverisë izraelite e refuzon duke i thënë: *“Ndërprerja e kolonisë do të thotë ndërprerja e jetës.”*

Propozimi për ndërprerjen e punës ishte 45 ditë. Gjatë atyre ditëve ishin festat jehude dhe punët u ndërpre, por jo për shkak të kërkesës së qeverisë, por për shkak të festave.

- Profesori Halil Tefikgjij, ekspert për kolonizimin e tokave palestineze, në deklaratën më të fundit, ka thënë: *“Kur të vijë koha për fillimin e bisedimeve (përfundimtare), nuk do të ketë kohë se për cilën koloni duhet të bisedohet dhe mund të thuhet se populli palestinez e humbi tokën e tij, para syve dhe pranë veshëve të botës.”*

Sipas shënimeve të fundit del se:

74 % e Bregut Perëndimor është marrë;

40 % e më shumë e Rripit të Gazës është marrë;

87 % e tokës së Kudsit arab (lindor) është marrë.

Në fund, Refail Ijtan thotë: *“Krahina palestineze nuk do të ketë sipërfaqe toke më shumë se sa një arab t’i hipë gomarit dhe të shkojë në mes të vendeve të Nijranit (ka për qëllim kolonitë Medxhexhetin në Selah, e cila gjendet në mes të Palestinës së izoluar).”*

Burimet:

- Kolonizimi Izraelit në të ardhmen në Bregun Perëndimor, Gjefri Erinson 1996, Organizata e Studimeve Palestineze.
- Planprogrami Izraelit në qytetet e Bregut Perëndimor, Antoni Quin 1995, Organizata e Studimeve Palestineze.
- Kolonizimi gjatë qeverisjes Likude, Halid Ajid 1987, Organizata e Studimeve Palestineze.
- Revista “Pasqyra e Egjyptit”, nr.3738, viti 1417 hixhrij.

Të mendojmë patjetër, duhet të ndalemi për këtë situatë të dhimbshme. Armiku i pashpirt dhe sundimi i tij në tokën e Israsë, dora e të cilit dëshiron të arrijë në çdo pëllëmbë të tokës, merr, mbyll, luan, falsifikon, pastaj vret e dëbon, ose izolon e i maltreton, për të vendosur koloni, e aty të vendosë kolonë të vendeve të largëta.

Pyetja është: *A duhet që banorët stoikë të kësaj toke të lihen të vetmuar për t'u ballafaquar nga këto sulme kriminele të pashpirt?! Apo ta shtrijmë dorën e ndihmës materiale dhe morale që t'i forcojmë deri sa Allahu t'ua heqë atyre fatkeqësinë dhe të fitojnë? (Siç përmend ajeti):*

“Dhe thonë: Po, kur do të jetë ajo fitore? Thuaj: Ndoshta është shumë afër.”

Palestina përgjithmonë është islame



Fotografi nga ajri ku shihet një koloni izraelite në periferi të Mesxhidi Aksasë. Vërehen qartë ndërtesat të ndërtuara prej betonit, në formën e kullave me mure mbrojtëse. Kolonia është e ndërtuar në maje të kodrës, më poshtë janë lagjet e Mesxhidi Aksasë. Ndërsa kolonia është e rrethuar edhe me rrugë kryesore. Allahu i Lartmadhëruar e ka thënë të vërtetën ku thotë:

لا يُقَاتِلُونَكُمْ جَمِيعًا إِلَّا فِي قَرْيٍ مُحَصَّنَةٍ أَوْ مِنْ وَرَاءِ جُدُرٍ بَأْسُهُمْ بَيْنَهُمْ شَدِيدٌ تَحْسِبُهُمْ
جَمِيعًا وَقُلُوبُهُمْ شَتَّى ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْقِلُونَ

“Ata të gjithë së bashku nuk kanë guxim t’ju luftojnë, vetëm kur gjenden në ndonjë vend të fortifikuar ose kur janë pas ndonjë muri. Armiqësia ndërmjet tyre është e ashpër. Mund të mendohet për ta se janë të bashkuar, e në realitet zemrat e tyre janë të përçara, sepse janë njerëz që nuk logjikojnë.”

(El-Hashër, 14)

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpikët të Kur'anit”.
21. “Mesxhidi Aksaja pika kritike palestinezo-izraelite”.
22. “Dashuria”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim);
2. “Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi);
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrezak Nufel);
4. “Për Kushtetutën Islame” (nga autori Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer);
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. “Vlera e kohës” (nga autori Amër Halid);
7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid);
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid);
9. “Pendimi” (nga autori Amër Halid);
10. “Pasojat e mëkateve” (nga autori Amër Halid);
11. “Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
12. “Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
13. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir).
14. “101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe devotshmërisë”.

Përmbajtja:

Hyrje	3
STRATEGJIA E KOLONIZIMIT JEHUD NË BREGUN PERËNDIMOR	6
PJESA E KUDSIT TË SHENJTË	14
RRIPI I GAZËS	17
KOLONIZIMI NË EPOKËN E PAQES 1992-1997.....	19
LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit).....	26

Dr. Musli Vërbani

MESXHIDI AKSAJA

**PIKA KRITIKE
PALESTINEZO - IZRAELITE**

Recenzent:

Mr. Ajni Sinani

Korrektor:

Mr. Ajni Sinani


Radhitja kompjuterike:

Mumin Shehu

Shtypi:



Foto e Mesxhidi Aksasë dhe hyrja në oborr ku para saj është Kubeja e Sahrasë




Kubeja e Sahrasë, e cila është në mes të sipërfaqes së Mesxhidi Aksasë



Sipërfaqja e Mesxhidi Aksasë - ndërtesat e mëdha të Mesxhidi Aksasë ndërsa në mes të sipërfaqes shihet qartë Kubeja e Sahrasë

Sipërfaqja e Mesxhidi Aksasë, në hyrje është Mesxhidi Aksaja, ndërsa në mes të sipërfaqes shihet qartë Kubeja e Sahrasë



Fotografia e imagjinuar e kalasë, të cilët jehudët planifikojnë ta ndërtojnë në themelet e Mesxhidi Aksasë, në të cilën gjendet edhe Kubeja e Sahrasë